




Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 08/01/2013
Nr. 0204 - 1362

PËR: Rufki Suma, Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
Menduh Vlashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit.

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIEVE KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT
Nr. 01/8306/2012; 01/Nr. 8010/2012; 01/Nr. 8122/2012; 01/Nr. 8135/2012

Pranuar me datë, 31/12/ 2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimeve Nr.01-8306/2012; 01/Nr. 8010/2012; 01/Nr. 8122/2012; 01/Nr. 8135/2012 të miratuar me datë 27/12/2012, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtyre akteve dhe vlerëson se të njëjtat janë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.


Aktet juridike të listuar si në vijim të cilat kanë efekt të plotë juridik;

- Propozim Vendim nr. 01-8306/2012 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Vendim 01/Nr. 8010/2012 për dhënien e pëlqimit për kompaninë "ARSI" SH.P.K. për hulumtime gjeologjike me shpim;
- Vendim 01/Nr. 8122/2012 për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2013;
- Vendim 01/Nr. 8135/2012 për miratimin e planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2013.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum ,08/01/2013
br.0204 - 1362

Za: Rufki Suma, Gradonačelnik opštine Deneral Janković
Menduh Vlashi, Predsedavajući Skupštine opštine Deneral Janković.

Predmet: Potvrda zakonitosti odluka opštine Deneral Janković br. 01/8306/2012; 01/br. 8010/2012; 01/br. 8122/2012; 01/br. 8135/2012

Primljeno dana , 31/12/ 2012

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva , nakon detaljnijeg razmatranja odluka br.01-8306/2012; 01/br. 8010/2012; 01/br. 8122/2012; 01/br. 8135/2012 odobreno dana 27/12/2012, **POTVRĐUJE zakonitost** ovih akata i procenjuje da isti ti akti su u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.

Pravni aktovi sa potpunim pravnim dejstvom su kao što sledi;

- Predlog odluka br. 01-8306/2012 o osnivanju opštinskog saveta za bezbednost zajednice.
- Odluka 01/br. 8010/2012 za davanje saglasnosti kompanije "ARSI" Š.P.K. za geološka istraživanja bušenjem ;
- Odluka 01/br. 8122/2012 o odobrenju plana rada Skupštine opštine Deneral Janković za 2013 godinu;
- Odluka 01/br. 8135/2012 o odobrenju plana rada gradonačelnika opštine za 2013 godinu.

Sa postovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Direktorima odeljenja i kancelarija
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Elez Han

02843/2012

Data:	28.12.2012
PËR :	Departamenti Ligjor i MAPI-së z. Agron Maxhuni Kryetari i Komunës Rufki Suma
PËRMES:	
NGA :	Shefi i Zyrës Ligjore Bajrush Laçi
LËNDA:	Vendimet e Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit për muajin DHJETOR

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES VLAKA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum
Date

31.12.2012

Nivelo-organizativ	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vite
III	204-1362	5	

I nderuar z.Maxhuni;

Duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës me nr. 03/L-040, përkatësisht neni 80 nënparagrafi 80.1, dërgojmë për shqyrtim të rregullt këto vendime të Kuvendit të Komunës siç vijojnë:

1. Vendim për harmonizimin dhe transferin e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike paga dhe mëditje për vitin 2012. nr.01-8301/2012
2. Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. nr. 01-8306/2012.
3. Vendim për dhënien e pëlqimit për hulumtime gjeologjike me shpim. nr. 01-7946/2012.
4. Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2013. nr. 01-8122/2012.
5. Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kryetarit për vitin 2013. nr. 01-8135/2012.

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA HANË ELEZIT
MUNICIP. OF HANË ELEZIT

Dt: 13.12.2012

02/nr. 8306 /2012

NGA:	Rufki Suma, Kryetar i Komunës
PËR:	Komitetin për Politikë dhe Financa
LËNDA:	SHKRESË PËRCJELLËSE – Propozim Vendim për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Të nderuar anëtarë të KPF-së

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim propozim vendimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Aktualisht ky këshill ka funksionuar deri më tani dhe funksionon, por me nxjerrjen e Udhëzimit të ri Administrativ 27/2012, neni 3 themelimi i KKSBB-së, potencon se Kuvendi i Komunës me vendim themelon KKSBB.

Në kuadër të këtij neni përbërja e KKSBB-së është nga:

- Kryetari i Komunës- Kryesues
- Komandanti i Stacionit të policisë në komunën përkatëse
- Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës përkatëse
- Nga një përfaqësues të secilit komitet etnik të komunës përkatëse
- Kryesuesi i komitetit për komunitete
- Zyrtari për barazi gjinore
- Drejtori i drejtorisë për arsim
- Kryetari i këshillit të prindërve të arsimit të komunës përkatëse
- Një përfaqësues i FSK-së
- Një përfaqësues i secilit këshill lokal për siguri publike
- Kryesuesi i ekipit veprues për siguri në bashkësi
- Një përfaqësues i emergjencave civile komunale
- Përfaqësuesi i zyrës komunale për komunitete dhe kthim
- Një përfaqësues nga OJQ-të, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara

Me respekt.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna – Hani i Elezit
Municipality of Hani Elezit

02/_____/2012

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës me nr. 03/L-040, nenin 58 mbi përgjegjësitë e kryetarit të komunës, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, për këshillat komunale për siguri në bashkësi nr.27/2012, Kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR

THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

- I. Me këtë propozim vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Hanit të Elezit
- II. KKSBJ-a do të ketë përbërjen e tij sipas Udhëzimit Administrativ të MPB-së nr.27/2012, të nenit 3 për themelimin e KKSBJ-së.
- III. Propozim vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes nga Kuvendi i Komunës.
- IV. Ekzekutimin e këtij propozim vendim e kryen Kryetari i Komunës.
- V. Me këtë propozim vendim njoftohen: Anëtarët e Bordit Komunal, Drejtoria për buxhet dhe financa dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Data : 13.12.2012
Hani i Elezit

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assembly of Elez Han

01/Nr.8010/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës - Nr. 28/2008) neni 11, 40, Statutin e Komunës neni 79, shkresën përcjellëse me numër 11/Nr.8106 të datës 05.12.2012 nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit me numër 11-Nr.8096/2012. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012 mori:

VENDIM

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KOMPANIN „ARSI“ SH.P.K PËR HULUMTIME GJEOLGJIKE ME SHPIM

I

I jepet në parim pëlqimi kompanisë „Arsi“ sh.p.k për shfrytëzimin e parcelave me numër Nr.1362, 1368 dhe 1373 mal i klasit të shtatë, kullos e klasit të shtatë në vendin e quajtur „Rudin“ e evidentuar në certifikatën e pronësisë Nr.137 pronë shoqërore e ekonomisë pyjore zona kadastrale Gorancë me një sipërfaqe prej 268 89 11 ha për hulumtime gjeologjike me shpim për krom dhe bakër.

II

Komuna e Hanit të Elezit në parcelën e lartë shënuar nuk ka plan rregullativ hapësinor, kurse pala për dokumentacionet e tjera të nevojshme duhet të drejtohet në Agjensionin e Pyjeve të Republikës së Kosovës pasi që prona e kërkuar është e ekonomisë pyjore.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës

IV

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Pala, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:27.12.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vllasi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assembly of Hani Elezit

01/Nr. 8122/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008 nenit 11, 12.1, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2012 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2013

I

Miratohet plani i punës së kuvendit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2013.

II

Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit për vitin 2013 planifikon të mbajë gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe çdo mbledhje të kuvendit i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Hani të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore të paraqitura si në tabelë:

Mbledhja	Temat që do të diskutohen	Afati i realizimit
Mbledhja e (I)	• Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHMI në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2012-2013. • Miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete dhe Komiteteve Konsultative. • Shqyrtimi i rregullores për barazi gjinore.	Janar
Mbledhja e (II)	• Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2012. • Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2012. • Miratimi i raportit të punës së Kuvendit për vitin 2012. • Propozim vendim për bartjen e të HVK nga viti 2012 në vitin 2013. • Miratimi i rregullores për barazi gjinore.	Shkurt
Mbledhja e (III)	• Miratimi i raporteve të punës së Komitetit për Komunitete dhe Komiteteve Konsultative. • Shqyrtimi i emërimit të rrugëve të vendbanimeve të Komunës së Hani të Elezit. • Shqyrtimi i Projekt rregullores për Taksa, tarifa dhe ngarkesa.	Mars

Mbledhja e (IV)	• Miratimi i raportit tremujor të shpenzimeve. • Miratimi i emërimit të rrugëve të vendbanimeve të Komunës së Hanit të Elezit. • Miratimi i Rregullores për Taksa, tarifa dhe ngarkesa. • Shqyrtimi i draft rregullores për ndarjen e subvencioneve.	Prill
Mbledhja e (V)	• Miratimi i rregullores për ndarjen e subvencioneve. • Miratimi i rishikimit të Buxhetit për vitin 2013. • Shqyrtimi i Statutit të QPS-së.	Maj
Mbledhja e (VI)	• Shqyrtimi i projekt rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme. • Miratimi i Statutit të QPS-së.	Qershor
Mbledhja e (VII)	• Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të punës së Kryetarit të Komunës. • Miratimi i raportit gjashtëmujor i shpenzimeve buxhetore. • Miratimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve për vitet 2014/2016	Korrik
Mbledhja e (VIII)	• Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2012-2013. • Raporti i Auditimit për vitin 2012.	Gusht
Mbledhja e (IX)	• Miratimi i Buxhetit për vitin 2013. • Informatë e DKA-së për fillimin e vitit të ri shkollor 2013/2014. • Shqyrtimi i draft rregullores për dhënien e lejes mjedisore. • Miratimi i rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme.	Shtator
Mbledhja e (X)	• Shqyrtimi i raportit të suksesit të arritur në fund të vitit shkollor 2013/2013. • Miratimi i raportit nëntëmujor të shpenzimeve. • Shqyrtimi i planit rregullues. • Shqyrtimi i draft rregullores për shërbime sociale. • Miratimi i rregullores për dhënien e lejes mjedisore.	Tetor
Mbledhja e (XI)	• Miratimi i rregullores për shërbime sociale.	Nëntor
Mbledhja e (XII)	• Shqyrtimi i Planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2014. • Miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2014. • Miratimi i Planit Rregullues.	Dhjetor

IV

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2013, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të Rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e Rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.

V

Të gjitha mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

VI

Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.

VII

Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike. Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Pushtetit Lokal.

VIII

Plani i mbledhjeve të kuvendit, i përcaktuar si në pikën III të këtij Vendimi, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.

IX

Plani i mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2013, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2013.

X


Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës, me këtë vendim njoftohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit të Komunës.

Hani i Elezit

Data:27.12.2012

Kryesuesi i Kuvendit

Elendin Ylashi





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assembly of Hani i Elezit

01/Nr. 8135 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008 nenit 11, 12.1, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2012 merr këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2013

I

Miratohet plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2013.

II

Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2013 përbën detyrat, dhe përgjegjësit e punës së drejtorive të komunës në bazë të ligjeve të aplikueshme dhe Statutit të Komunës.

III

Vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Drejtoria për Arsimit dhe Kulturë Rini dhe Sport, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria e Politikave Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.12.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Mendut Vashi

